

VENDIM
Nr. 27, datë 29.6.2021

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

(Ndryshuar me vendimin nr. 27/1, datë 5.11.2021)

(I përditësuar)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vitore Tusha	kryetare e Gjykatës Kushtetuese
Elsa Toska	anëtare e “ “
Marsida Xhaferllari,	anëtare e “ “
Fiona Papajorgji,	anëtare e “ “
Altin Binaj,	anëtar i “ “
Sonila Bejtja,	anëtare e “ “
Përparim Kalo,	anëtar i “ “

me sekretare Enina Kotoni, në datën 17.6.2021, mori në shqyrtim në seancë plenare publike çështjen nr. 3 (P) 2021, të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: PARTIA REPUBLIKANE E SHQIPËRISË, përfaqësuar me autorizim nga z. Dardan Mustafaj, avokat;

PARTIA AGRARE AMBIENTALISTE, në mungesë;

PARTIA LËVIZJA PËR ZHVILLIM KOMBËTAR, në mungesë;

PARTIA BASHKIMI PËR TË DREJTAT E NJERIUT, në mungesë;

PARTIA DEMOKRISTIANE E SHQIPËRISË, në mungesë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar me autorizim nga znj. Mimoza Arbi;

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, përfaqësuar me autorizim nga znj. Madalena Koja.

OBJEKTI: Shfuqizimi i fjalisë së dytë, të paragrafit të tretë, të nenit 88 të Kodit Zgjedhor ku parashikohet: “Për partitë pjesëtare në koalicion, numri i votave të vlefshme takuese përlogaritet duke mbledhur mesataren e votave për mandat për çdo kandidat të zgjedhur nga radhët e tyre”, si e papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 1, 4, 9, 17, 18, 22, 45, 47, 117, pika 1, 131, pika 1, shkronja “a”, neni 134, pika 1, shkronja “gj” dhe neni 134, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 27, 49, pika 3, shkronja “d”, 50, pika 1, 52, pika 2, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, Përparim Kalo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkueseve dhe shpjegimet që Partia Republikane dhe në seancën gjyqësore, e cila kërkoi pranimin e kërkesës, parashtrimet e subjekteve të interesuara, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (Kuvendi) dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kuvendi ka miratuar ligjin nr. 118/2020, datë 5.10.2020, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, 'Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë'", të ndryshuar (*ligji nr. 118/2020*), i cili është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 191, datë 3.11.2020, dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit të tij.

2. Me nenin 9, të ligjit nr. 118/2020, paragrafit të 3-të, të nenit 88 të Kodit Zgjedhor, iu shtua fjalia me këtë përmbajtje: *"Për partitë pjesëtare në koalicion, numri i votave të vlefshme takuese përlllogaritët duke mbledhur mesataren e votave për mandat për çdo kandidat të zgjedhur nga radhët e tyre."*

3. Nga ana tjetër, neni 180 i Kodit Zgjedhor, i ndryshuar nga neni 42, i ligjit nr. 101/2020, datë 23.7.2020, parashikon: *"1. Zbatimi i nenit 88 të këtij ligji për financimin e fushatës zgjedhore për zgjedhjet e para të përgjithshme pas hyrjes në fuqi të tij bëhet duke kryer përlllogaritjet në bazë të rezulttit të zgjedhjeve në shkallë vendi për zgjedhjet vendore të vitit 2015 dhe për zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2017. 2. Për secilën parti përfshihet në përlllogaritje shifra që pasqyron numrin më të lartë të votave që partia ka marrë në njërin nga këto dy zgjedhje, kur ajo është jo më e vogël se 1 për qind e votave të vlefshme në zgjedhjet përkatëse. Në përlllogaritje përfshihet edhe rezultati i subjekteve zgjedhore, që nuk kanë marrë pjesë në ato zgjedhje, por që kanë marrë pjesë në zgjedhjet vijuese dhe që plotësojnë kushtin e përcaktuar në nenin 88 të këtij ligji për kufirin prej 1 për qind të votave të vlefshme të fituara prej tyre. 3. Totali i fondit buxhetor që është për t'u shpërndarë pjesëtohet me totalin e votave të përfutuara nga përlllogaritjet sipas pikës 2 të këtij neni. Rezultati që del formon vlerën në lekë për një votë. 4. Në zgjedhjet e para pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, fondi nga Buxheti i Shtetit për financimin e partive pjesëmarrëse në zgjedhje do të jetë 2 herë më i madh se fondi i alokuar për zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2017."*

4. Partia Republikane, Partia Agrare Ambientaliste, Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar, Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, Partia Demokristiane e Shqipërisë (*kërkueset*), të cilat janë regjistruar për të marrë pjesë në zgjedhjet e përgjithshme të datës 25 prill 2021, i janë drejtuar në datën 12.2.2021, Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), duke kërkuar shfuqizimin e fjalisë së dytë, të paragrafit të tretë, të nenit 88, të ligjit nr. 118/2020, me përmbajtjen: *"Për partitë pjesëtare në koalicion, numri i votave të vlefshme takuese përlllogaritët duke mbledhur mesataren e votave për mandat për çdo kandidat të zgjedhur nga radhët e tyre."*

5. Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në datën 2.4.2021, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila në datën 21.4.2021 vendosi kalimin e saj në seancë plenare publike.

6. Zgjedhjet e përgjithshme parlamentare u zhvilluan në datën 25 prill 2021. Të pesta kërkueset kanë marrë pjesë në zgjedhje si pjesë e koalicionit PD-AN.

7. Gjatë seancës plenare publike për subjektet kërkuese në gjykimin kushtetues, u paraqit vetëm Partia Republikane. Kërkueset e tjera, megjithëse morën dijeni rregullisht për zhvillimin e seancës, nuk u paraqitën dhe as depozituan parashtrime me shkrim.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

8. **Kërkueset** dhe më tej Partia Republikane, edhe në seancën publike, kanë parashtruar në mënyrë të përmbledhur se norma objekt kundërshtimi cenon:

8.1 *Parimin e barazisë para ligjit dhe të mosdiskriminimit*, i parashikuar në nenin 18 të Kushtetutës, pasi ajo kushtëzon financimin e subjekteve për fushatën zgjedhore, duke u mbështetur vetëm mbi një kriter: pjesëmarrjen ose jo në koalicion parazgjedhor, duke krijuar kështu situatë pabarazie mes subjekteve pjesëmarrëse në zgjedhje. Koalicioni si subjekt zgjedhor është formë organizimi që mund të krijohet *ad hoc* me pjesëmarrjen e disa subjekteve me synimin e marrjes të sa më shumë votave në zgjedhje. Norma objekt kundërshtimi krijon situatë diskriminuese për koalicionin, pasi ndryshe nga subjektet zgjedhore që konkurrojnë më vete, jo të gjitha votat e

fituara prej koalicionit prodhojnë mandate përfaqësimi. Shteti e ka për detyrë të qëndrojë asnjans në financimin publik të fushatës zgjedhore dhe në zbatim të parimit të barazisë “proporcionale”, të respektojë dhe garantojë parimin e shanseve të barabarta për të gjitha partitë pjesëmarrëse në zgjedhje. Norma e shtuar synon të pengojë partitë politike për t’u inkuadruar në koalicione zgjedhore, madje t’i largojë fare nga gara elektorale, kur parandiejnë se mundësia e zgjedhjes së kandidatëve të paraqitur prej tyre është e vakët. Partitë politike kanë nevojë për financim për të përmbushur funksionet e tyre si gjatë periudhës zgjedhore, ashtu edhe gjatë veprimtarisë së përditshme, bazuar në parimin e mundësive të barabarta, në kuadrin e proporcionalitetit, sipas votave të marra prej tyre. Formula e re e përlllogaritjes së votave të partive që inkuadrohen në koalicion krijon diskriminim krahasuar me partitë që garojnë më vete. Këtyre të fundit, për efekt financimi për zgjedhjet, u llogariten të gjitha votat, gjë që ua konsolidon pozitën në spektrin politik. Ndarja e fondeve të buxhetit të shtetit për efekt të fushatës zgjedhore në favor të subjekteve zgjedhore, mbi bazën e kriterit aritmetik dhe të barazisë proporcionale, janë kriteret e duhura e të drejta dhe zëvendësimi i tyre me kriteret e tjera kufizuese ose përjashtuese, sjell ndikim negativ të drejtpërdrejtë mbi të drejtën kushtetuese themelore të zgjedhjes.

8.2 *Barazinë e votës dhe barazinë e konkurruesve në zgjedhje.* Financimi i subjekteve zgjedhore nga buxheti i shtetit për fushatën zgjedhore është një e drejtë me rëndësi kushtetuese, e cila shkrihet me parimin e barazisë së votës. Shpërndarja e financimit duhet të bëhet bazuar në numrin e votave që fiton çdo subjekt zgjedhor. Norma e re cenon shanset e barabarta të subjekteve zgjedhore, sepse i jep shtetit në dorë një mekanizëm nëpërmjet të cilit mund të favorizohen subjektet që garojnë më vete, Ligjvënësi ka parashikuar që shpërndarja e fondeve të bëhet sipas rezultatit të të gjitha votave për subjektet zgjedhore që garojnë më vete, ndërkohë norma objekt kundërshtimi e ka kufizuar financimin e partive që garojnë brenda koalicioneve, duke u llogaritur vetëm votat me të cilat krijohet mandat, pra, duke mos përfshirë në llogaritje edhe votat që secila nga partitë e koalicionit mund të fitojë përtej numrit të votave që nevojiten për të prodhuar mandat.

8.3 Janë cenuar edhe parashikimet e nenit 83, paragrafit të 3-të, të Kushtetutës, pasi është shkelur procedura e miratimit të ligjit nr. 118/2020, duke përdorur procedurën e përshpejtuar. Nga verifikimi i procesverbaleve të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtat e Njeriut rezulton se ligji është shqyrtuar në datën 28.9.2020 dhe është votuar në datën 5.10.2020, afate që flasin për zbatimin e një procedure të përshpejtuar.

9. ***Subjekti i interesuar, Kuvendi,*** ka parashtruar në mënyrë të përmblodhur, si më poshtë:

9.1 Pas ndryshimeve në Kodin Zgjedhor me ligjet nr. 101/2020 dhe nr. 118/2020, partive iu krijua mundësia e barabartë të hyjnë me vullnetin e tyre të lirë në garën zgjedhore, të vlerësojnë dhe të zgjedhin mënyrën e konkurrimit në zgjedhje, pra si subjekte më vete ose brenda koalicioneve dhe, për rrjedhojë, në bazë të rregullave të përcaktuara më parë, të parashikojnë shkallën e suksesit të tyre. Koalicioni i partive politike regjistrohet si subjekt zgjedhor me listë të përbashkët.

9.2 Marrja pjesë në garë brenda koalicionit e bën të pamundur të votohet nominalisht për partitë politike që janë pjesë e koalicionit, pasi votimi bëhet për koalicionin si subjekt. Nisur nga rëndësia e financimit të fushatës zgjedhore, për të bërë të mundur që nga fondet e financimit që merr koalicioni si subjekt zgjedhor të përfitojnë edhe partitë që inkuadrohen brenda tij, ligjvënësi nuk e ka lënë atë në fatin e marrëveshjeve private ndërpartiake të koalicioneve zgjedhore, por ka vendosur ta normojë në mënyrë taksative në Kodin Zgjedhor. Për sa i përket financimit të partive që garojnë më vete, ai përlllogaritet sipas numrit të votave të vlefshme të fituara prej tyre si subjekte zgjedhore, si dhe të numrit të votave që marrin kandidatët, duke e shumëzuar numrin e përgjithshëm të tyre me vlerën në lekë për çdo votë. Nëpërmjet kësaj norme ligjvënësi ka

përdorur diskrecionin e vet për të bërë të mundur llogaritjen sa më të përafërt të peshës elektorale të secilës parti politike dhe financimin e tyre me fonde publike sipas peshës përkatëse.

9.3 *Pretendimi për cenimin e parimit të mosdiskriminimit* është i pabazuar, pasi trajtimi financiar nga fondet publike i një partie politike që garon në zgjedhjet e përgjithshme si subjekt zgjedhor më vete, nuk mund të jetë i njëjtë me atë të një partie politike që garon në kuadrin e një koalicioni, pasi ato nuk ndodhen në rrethana e pozita juridike të njëjta. Një koalicion ka mundësi e shanse më të mëdha të marrë vota, veçanërisht në kushtet aktuale të Kodit Zgjedhor që parashikon se koalicionet garojnë me lista të përbashkëta kandidatësh. Ndryshimi kushtetues që uli pragun elektoral kombëtar synon të nxisë dhe motivojë partitë e vogla politike për t'u mundësuar atyre përfaqësimin në parlament përmes platformave politike bindëse, pa u kufizuar në marrjen e votave në një ose disa zona zgjedhore, por duke u shtrirë në një hapësirë më të gjerë territoriale.

10. ***Subjekti i interesuar, KQZ-ja***, ka prapësuar, duke argumentuar:

10.1 Neni 19, paragrafi i 1-rë, shkronjat “k” dhe “n”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikon kompetencën e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për përcaktimin e fondit publik që do t'u shpërndahet si paradhënie partive të regjistruara si subjekte zgjedhore.

10.2 KQZ-ja ka autoritetin dhe përgjegjësinë të mbikëqyrë dhe të kontrollojë fondet e përfituara dhe shpenzimin e tyre nga partitë politike, si gjatë ashtu edhe jashtë periudhës zgjedhore, si dhe të hartojë aktet nënligjore në zbatim të Kodit Zgjedhor dhe ligjit 8580/2000, “Për partitë politike”, të ndryshuar.

10.3 Nenet 88 dhe 180 të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar, përcaktojnë mënyrën e përlllogaritjes së fondit të përgjithshëm dhe shumën që i takon të marrë secila parti në formë paradhënieje. Neni 88 i Kodit Zgjedhor parashikon se subjektet pjesëmarrëse në zgjedhje, të cilat kanë marrë jo më pak se 1 %, në shkallë vendi, në zgjedhjet pararendëse të të njëjtit lloj, përfitojnë fonde nga buxheti i shtetit në bazë të numrit të votave që kanë marrë në ato zgjedhje.

10.4 Vlera monetare e një vote të vlefshme përcaktohet nga KQZ-ja bazuar në rezultatet përkatëse dhe shuma takuese llogaritet duke shumëzuar vlerën e një vote me numrin e votave të vlefshme që ka fituar secila parti në zgjedhjet pararendëse.

10.5 Kërkeset vendosën që në zgjedhjet e 25 prillit 2021 të marrin pjesë jo më vete, por brenda koalicionit PD–AN, i cili garoi nën një sigël të vetme dhe me listë të përbashkët kandidatësh. Këta të fundit shfaqen në fletën e votimit jo si kandidatë të partisë së tyre, por si kandidatë të koalicionit. Nga ana tjetër, në fletën e votimit nuk shfaqet as emri, as sigla e partive pjesëtare të koalicionit. Zgjedhësit kanë të drejtë të votojnë kandidatin që parapëlqejnë në listën shumëmemërore të koalicionit. Nëse ligjvënësi do të kishte pasur si qëllim të evidentonte partinë politike të kandidatit do të kishte gjetur edhe zgjidhje për ta pasqyruar partinë përkatëse në fletën e votimit, por ai nuk e ka lidhur votën parapëlqyese brenda një koalicioni me përkatësinë partiake të kandidatit.

10.6 Pas ndryshimeve kushtetuese të vitit 2020, ku përfshihej ndryshimi në konceptimin e sistemit zgjedhor, ligjvënësi e çmoi të domosdoshme të bënte ndryshime edhe në Kodin Zgjedhor, ku bën pjesë edhe formula e re për ndarjen e fondeve përkatëse të buxhetit të shtetit për partitë pjesëtare në koalicione. Ky ndryshim bën të mundur që partitë politike pjesëtare të koalicioneve nga njëra anë, dhe KQZ-ja, nga ana tjetër, të përlllogarisin shumën takuese të financimit për secilën parti të koalicionit. Kjo përlllogaritje mund të arrihej edhe me marrëveshje brenda tij, por partitë pjesëtare të tij do të ndodheshin në një situatë pasigurie, pasi të gjitha të drejtat e detyrimit sipas Kodit Zgjedhor mbahen dhe ushtrohen nga partia udhëheqëse e koalicionit.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkueseve

11. Legjitimimi i subjekteve kërkuese (*locus standi*) është çështje e rëndësishme që kushtëzon vënien në lëvizje të procesit kushtetues. Partitë politike, bazuar në nenin 134, pika 1, shkronja “g”, nenin 134, pika 2, të Kushtetutës, si dhe në nenin 49, pika 3, shkronja “d” dhe pika 4, të ligjit nr. 8577/2000, bëjnë pjesë në rrethin e subjekteve që mund të paraqesin kërkesë në Gjykatën Kushtetuese vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre.

12. Kërkuestet, konkretisht Partia Republikane e Shqipërisë (PR), Partia Agrare Ambientaliste (PA), Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar (LZHK) dhe Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut (PBDNJ) janë parti politike të themeluara e të regjistruara rregullisht dhe nisur nga kjo, Gjykata vlerëson se ato legjitimohen *ratione personae*. Për më tepër, njëra prej tyre, PR-ja, e ka vënë disa herë në lëvizje Gjykatën për kontrollin kushtetues të normave (*shih vendimet nr. 15, datë 15.4.2010; nr. 28, datë 9.5.2012; nr. 1, datë 16.1.2017; nr. 11, datë 9.3.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Gjykata vlerëson se kërkuestet legjitimohen edhe *ratione temporis*, bazuar në nenin 50, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, sipas të cilit kërkesat në Gjykatën Kushtetuese për shqyrtimin e pajtueshmërisë së ligjit me Kushtetutën duhet të paraqiten brenda dy viteve pas datës së hyrjes në fuqi të aktit. Në rastin konkret, ligji nr. 118/2020 ka hyrë në fuqi në datën 18.11.2020 dhe kërkesa në Gjykatën Kushtetuese është depozituar në datën 12.2.2021, pra brenda afatit ligjor.

14. Për sa i përket legjitimitetit *ratione materiae*, Gjykata vlerëson se është rasti të ritheksojë qëndrimin e saj se në gjykime me objekt kontrollin e kushtetutshmërisë së normës, subjektet që parashikohen në nenin 134, pika 2, të Kushtetutës kanë detyrimin të provojnë lidhjen e domosdoshme që duhet të ekzistojë ndërmjet funksionit e veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur. Partitë politike përfshihen në nenin 134, paragrafi i 1-rë, shkronja “g”, të Kushtetutës, si subjekte që e ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për t’iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese. Ato kanë legjitimitetet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre dhe Gjykata ka theksuar se në çdo rast interesat duhet të provohen dhe justifikohen.

15. Konkretisht, kërkuesi duhet, së pari, të saktësojë se në çfarë cilësie vepron kundër normës së kundërshtuar dhe, më pas, të vërtetojë se në çfarë mënyre mund të preket në një aspekt të çfarëdoshëm të situatës së tij, pra duhet të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që ekziston midis situatës së tij dhe normës që kundërshton (*shih vendimin nr. 16, datë 25.7.2008, të Gjykatës Kushtetuese*). Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak (*shih vendimet nr. 2, datë 28.4.2009; nr. 16, datë 25.7.2008; nr. 9, datë 19.3.2008; nr. 41, datë 16.11.2007; nr. 35, datë 10.10.2007; nr. 11, datë 4.4.2007; nr. 9, datë 26.2.2007, të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Partitë politike në sistemin e zgjedhjeve, veçanërisht në procesin zgjedhor, që nga fushata parazgjedhore, paraqitja e kandidatëve, formimi i trupave zgjedhore, ndjekja e zgjedhjeve e deri te ndarja e mandateve, paraqiten si faktorë përcaktues shumë të rëndësishëm. Prandaj, si demokracia përfaqësuese, ashtu edhe sistemi i zgjedhjeve nuk mund të paramendohen pa ekzistencën dhe funksionimin e partive politike. Ky pozicion i veçantë që partitë politike kanë në raport me zgjedhjet, përcakton njëkohësisht edhe interesin e tyre për të pasur një legjislacion dhe rregulla sa më të qarta e të drejta (*shih vendimet nr. 11, datë 13.3.2015; nr. 1, datë 7.1.2005, të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Nisur nga sa më lart, Gjykata vlerëson se kërkuestet legjitimohen edhe *ratione materiae*, pasi ato pretendojnë se fjalë e dytë, në paragrafin e 3-të, të nenit 88, të Kodit Zgjedhor “Për partitë pjesëtare në koalicion, numri i votave të vlefshme takuese përlllogaritët duke mbledhur mesataren e votave për mandat për çdo kandidat të zgjedhur nga radhët e tyre”, shtuar përmes nenit 9, të ligjit nr. 118/2020, cenon parimin e barazisë para ligjit dhe të mosdiskriminimit, barazinë e votës dhe konkurrimin e lirë të partive, duke deformuar financimin e drejtë që duhet të zbatohet për të gjitha partitë politike.

18. Përveç pretendimeve për cenimin e barazisë para ligjit dhe të mosdiskriminimit, si dhe të barazisë së votës dhe konkurrimit në zgjedhje, kërkueset kanë pretenduar, gjithashtu, se ligji që përmban normën objekt kundërshtimi është miratuar me procedurë të përsheptuar, pra në shkelje të nenit 83, paragrafit të 3-të, të Kushtetutës. Gjykata vëren se ky pretendim ka të bëjë me çështje të një natyre kryesisht procedurale, formale, por duke qenë se ai është ngritur në kuadrin e pretendimeve me natyrë materiale, për të cilat kërkueset legjitimohen, ajo gjykon se është me vend ta vlerësojë edhe atë bashkë me shqyrtimin e pretendimeve të themelit.

19. Në vijim, Gjykata do të analizojë pretendimet e parashtruara në kërkesë, në këndvështrim të parimit të barazisë para ligjit, të lidhur me mosdiskriminimin, si dhe të parimit të barazisë së votës të lidhur me konkurrimin e lirë.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për parimin e barazisë para ligjit, të barazisë së votës dhe konkurrimit të lirë

20. Kërkueset pretendojnë se norma objekt kundërshtimi cenon parimin e barazisë para ligjit dhe të mosdiskriminimit, pasi krijon situatë pabarazie të subjekteve zgjedhore, sepse i trajton ndryshe vetëm duke u bazuar në faktin e pjesëmarrjes së tyre në zgjedhje si subjekt më vete ose si pjesë e një koalicioni zgjedhor. Jo vetëm partitë e koalicionit, por edhe vetë koalicioni diskriminohet, pasi do të marrë më shumë vota sesa mandate, kështu që jo të gjitha votat do të prodhojnë mandate përfaqësimi. Detyrimi për paanësi në financimin publik të fushatës zgjedhore, sipas parimit të barazisë “proporcionale”, nënkupton respektimin e parimit të shanseve të barabarta të të gjitha partive pjesëmarrëse në garën zgjedhore. Gjithashtu, cenohet edhe veprimtaria politike e partive, pasi ky parashikim ligjor bën rregullim të posaçëm, përjashtimor, të mënyrës së zakonshme të ndarjes së fondit buxhetor për partitë, që bazohet te votat që ato kanë fituar, duke parashikuar që për partitë pjesëtare në koalicione numri i votave takuese përcaktohet nga mandatet që do të fitojë secila parti e koalicionit.

21. Kërkueset, në kuadër të parimit të barazisë para ligjit dhe shtetit të së drejtës, kanë pretenduar se fjalë e dytë, e paragrafit të 3-të, të nenit 88, të Kodit Zgjedhor, bie në kundërshtim me parimin e barazisë së votës dhe të konkurrimit të lirë. Shpërndarja e financimit duhet të bëhet duke llogaritur çdo votë, në këtë kuptim dispozita cenon shanset e barabarta të subjekteve politike pjesëmarrëse në zgjedhje dhe i jep shtetit mundësinë të favorizojë ato që garojnë më vete. Nuk ekzistonte asnjë arsye që në ligjin zgjedhor të shtohet dispozita për krijimin e mekanizmave që cenojnë trajtimin e drejtë dhe shanset e barabarta në një garë zgjedhore. Shpërndarja e fondeve të financimit nga buxheti i shtetit, për fushatën zgjedhore, është proces me rëndësi kushtetuese dhe pjesë përbërëse e parimit të barazisë së votës. Për këtë arsye, zbatimi i tij dikton nevojën e përcaktimit të kriterëve të sakta për ndarjen e barabartë, proporcionalisht, të fondeve të buxhetit të shtetit për fushatën zgjedhore, bazuar në numrin e votave të fituara nga secila parti politike, duke shmangur vendosjen e kriterëve që janë në kundërshtim me parimin e barazisë së votës.

22. Subjekti i interesuar, Kuvendi, ka prapësuar se pas ndryshimeve në Kodin Zgjedhor, koalicioni i partive politike, si subjekt zgjedhor, regjistrohet dhe shfaqet me listë të përbashkët dhe është e pamundur të votohet nominalisht partia politike që është pjesë e koalicionit. Vlera e financimit që përfiton një parti nga buxheti i shtetit llogaritet mbi numrin e votave të vlefshme të fituara prej saj në zgjedhjet e përgjithshme, shumëzuar me vlerën monetare të një vote. Ndryshimet në Kodin Zgjedhor e bëjnë të pamundur matjen e peshës elektorale të një partie politike pjesëtare të një koalicioni. Kuvendi ka vendosur që për shkak të rëndësisë që paraqet financimi publik i partive politike, sidomos ai i fushatave zgjedhore, të mos ia lërë atë në dorë marrëveshjeve private mes partive të një koalicioni zgjedhor, por të normohet shprehimisht, në mënyrë taksative, në Kodin Zgjedhor. Edhe pretendimi për cenimin e parimit të mosdiskriminimit është i pabazuar, pasi nuk mund të vihet shenja e barazimit në trajtimin financiar nga fondet publike mes një partie politike që konkurren si subjekt zgjedhor më vete

dhe një partie politike që konkurron në përbërje të një koalicioni zgjedhor. Duke mos qenë në të njëjtat rrethana dhe pozita juridike, nuk mund të ketë rregullim ligjor të njëjtë për këto subjekte. Me ndryshimet në Kodin Zgjedhor, sipas Kuvendit, partive iu krijuan mundësi të barabarta, pasi secila prej tyre ka të drejtë të hyjë me vullnet të lirë në garën zgjedhore, të vlerësojë dhe të zgjedhë mënyrën e përfaqësimit dhe të konkurrimit në zgjedhje, si subjekt më vete ose brenda një koalicioni, dhe, për rrjedhojë, në bazë të rregullave të përcaktuara që më parë, të parashikojë pritshmëritë lidhur me shpërndarjen e financimit në bazë të votave dhe mandateve të marra.

23. Subjekti i interesuar, KQZ-ja, ka prapësuar se para ndryshimeve kushtetuese të vitit 2020, çështja e ndarjes së fondeve buxhetore në Kodin Zgjedhor trajtohej bazuar në konceptin e koalicioneve të përbëra, në fletët e votimit të cilave shfaqeshin emrat e partive përbërëse. Pas ndryshimeve kushtetuese të vitit 2020, të cilat sollën një koncept të ri të sistemit zgjedhor, ligjvënësi e çmoi të domosdoshme të bënte ndërhyrje në paragrafin e 3-të, të nenit 88 të Kodit Zgjedhor, duke shtuar fjalinë që përcakton formulën për mënyrën e shpërndarjes së fondeve partive pjesëtare të koalicioneve. Po të mos shtohej kjo fjalë as partitë politike pjesëtare të një koalicioni, as KQZ-ja nuk do të ishin në gjendje të përlogaritnin fondet takuese për to. Duke interpretuar më gjerë dispozitat e Kodit Zgjedhor, marrëveshja e koalicionit mund të ishte një instrument për të zgjidhur edhe marrëdhëniet financiare midis këtyre partive, por në çdo rast të drejtat dhe detyrimet që njeh Kodi Zgjedhor për të, do të ushtroheshin nga partia udhëheqëse e tij.

24. Partitë politike luajnë një rol të rëndësishëm në sistemin demokratik pluralist, pasi kontribuojnë në shfaqjen dhe përfaqësimin e vullnetit politik të popullit përmes pjesëmarrjes në zgjedhje dhe ndihmojnë në realizimin e sovranitetit të tij. Për shkak të këtyre funksioneve ato konsiderohen pjesëtare të domosdoshme dhe faktorë në zhvillimin e jetës politike e shoqërore të vendit. Në kuptimin kushtetues ato paraqiten si bashkime vullnetare mbi bazën e ideve, të bindjeve e pikëpamjeve politike të përbashkëta, që synojnë të ndikojnë në jetën e vendit nëpërmjet pjesëmarrjes në zgjedhje dhe përfaqësimit të popullit në organet e zgjedhura të pushtetit (*shih vendimet nr. 11, datë 13.3.2015; nr. 1, datë 7.1.2005, të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Gjykata konstaton se Kushtetuta i ka kushtuar rëndësi të veçantë partive politike, në funksion të parimeve të qeverisjes së vendit, bazuar në një sistem zgjedhjesh të lira, të barabarta, të përgjithshme e periodike (neni 1); ushtrimit të sovranitetit të popullit nëpërmjet përfaqësuesve të tij (neni 2) dhe pluralizmit politik, i cili përbën një prej bazave të këtij shteti, që ka për detyrë ta respektojë dhe ta mbrojë (neni 3). Në këtë kontekst, Kushtetuta jo vetëm garanton krijimin dhe veprimtarinë e lirë të partive politike (neni 9), por u ka dhënë atyre edhe një rol të posaçëm kushtetues në lidhje me paraqitjen e kandidatëve në procesin zgjedhor (neni 68) dhe në formimin e qeverisë (neni 96).

26. Financimi i partive politike është jetik për përmbushjen e rolit të tyre kushtetues, edhe përtej fushatave zgjedhore. Të ndërgjegjshme për këtë rol, ato duhet të bëjnë përpjekje për të siguruar të ardhura nga burime alternative, përveç kontributit nga buxheti i shtetit, sikurse janë ato që parashikohen në ligjin organik, si kontributet e anëtarësisë, dhurimet në të holla, në natyrë ose në formë shërbimesh e sponsorizimesh, si dhe huat ose kreditë sipas ligjit. Financimi i fushatës zgjedhore nga buxheti i shtetit kërkon vëmendje të shtuar për të shmangur tendencat e mundshme të ndikimit të papërshtatshëm që mund të ushtrojnë mbi to dhuruesit privatë, për të krijuar favore klienteliste. Financimi i shtetit për partitë politike është thelbësor për të garantuar pavarësinë e tyre nga burimet e tjera financiare dhe për t'i siguruar mundësinë për të konkurruar nga një pozicion i barabartë. Sa më shumë të subvencionohen nga shteti, aq më pak partitë politike do ta ndiejnë nevojën për të kërkuar fonde për veprimtarinë e tyre nga burime të tjera (*shih vendimin nr. 28, datë 9.5.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Gjykata është shprehur se edhe pse në parim mbështetja financiare e shtetit ndaj partive politike ka rëndësi në një shtet të së drejtës, kjo nuk do të thotë se ajo është e pakufizuar. Gjykata

vlerëson se kjo mbështetje mund të kufizohet mbi bazën e kontributit të partive politike, duke e vlerësuar atë në termat e “*seriozitetit të përpjekjeve të partive konkurruese*” ose të “*seriozitetit të qëllimeve elektorale të tyre*”, që shpreh një shkallë të përfaqësimit të tyre (*shih vendimin nr. 28, datë 9.5.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Nga sa më lart, meqenëse kërkueset ngrenë pretendime për mënyrën e përlogaritjes së votave të fituara në zgjedhjet e përgjithshme, si anëtare të koalicionit, Gjykata vëren se në nenin 64 të Kushtetutës përcaktohet sistemi zgjedhor në Republikën e Shqipërisë dhe partitë politike përcaktohen me termin “subjekt zgjedhor”. Në Kodin Zgjedhor ky termi, përveç partive politike, u referohet edhe koalicioneve dhe kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit. Kodi rregullon edhe mënyrën e regjistrimit të koalicioneve (*neni 65*). Termi “koalicion” përmendet edhe në nenin 96, paragrafit të 1-rë, të Kushtetutës sipas së cilit: “*Presidenti i Republikës, në fillim të legjislaturës, si dhe kur vendi i Kryeministrit mbetet vakant, emëron Kryeministrin me propozim të partisë ose koalicionit të partive, që ka shumicë në vendet në Kuvend*.”. Koalicioni, si koncept nuk trajtohet as nga ligji nr. 8580/2000, “Për partitë politike”, i ndryshuar, as nga Kodi i Praktikës së Mirë për Çështjet Zgjedhore. Termi “koalicion” në kuptimin e mirëfilltë gjuhësor është lidhje ose aleancë e përkohshme ndërmjet shteteve, partive (*shih Fjalorin e Gjuhës Shqipe, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2006*).

29. Gjykata, në vijim të sa shtjellohet në paragrafët pararendës, vlerëson se koalicioni është një formë organizimi, bashkim i përkohshëm i dy ose më shumë partive, i cili gëzon të njëjtat të drejta themelore si të ishte një parti politike, por u nënshtrohet rregullave ligjore që Kodi Zgjedhor parashikon posaçërisht në lidhje me mënyrën e trajtimit dhe të përlogaritjes së votave të marra prej tij si subjekt zgjedhor.

30. Sipas Kodit të Praktikës së Mirë në Fushën për Çështjet Zgjedhore, aty ku legjislati parashikon financimin publik, partitë politike duhet të kenë akses dhe të zbatojnë kërkesat minimale, të cilat duhet të jetë të arsyeshme dhe jo diskriminuese (*shih opinionin nr. 190/2002, Komisioni i Venecias, datë 18–19 tetor 2002*).

31. Edhe sipas Direktivave për Financimin e Partive Politike financim publik duhet të përfitojë çdo parti e përfaqësuar në parlament. Megjithatë, që të sigurohet barazia e mundësive për forcat e ndryshme politike, financimi publik mund të shtrihet edhe te subjektet politike që përfaqësojnë një pjesë domethënëse të elektoratit dhe që paraqet kandidatë për t’u zgjedhur. Masa e financimit mund të përcaktohet nga ligjvënësi në mënyrë periodike, bazuar në kriteret objektive. Në këtë drejtim rëndësi merr edhe përdorimi i arsyeshëm i së drejtës që ka ligjvënësi për të përdorur hapësirën e vet diskrecionale, pasi kjo e drejtë duhet ushtruar në harmoni me detyrimin për garantimin e njërit prej parimeve themelore kushtetuese, siç është ai i barazisë (*shih dokumentin e Komisionit të Venecias (2001) 8, mbledhja e 46-të plenare, datë 9-10 mars 2001*).

32. Duke iu rikthyer pretendimeve të parashtruara në kërkesë dhe gjatë seancës plenare, Gjykata vëren se, në thelb, ato kanë të bëjnë me cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit dhe konkurrimit të lirë, prandaj bazuar në parimin *iura novit curia* do t’i analizojë ato nën dritën e parimit të barazisë përpara ligjit, në këndvështrim të konkurrimit të lirë të partive në zgjedhje.

33. Në nenin 18 të Kushtetutës garantohet shprehimisht barazia para ligjit, kurse në paragrafët 2 dhe 3 të tij sanksionohet se askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht, ndër të tjera, as për shkak të bindjeve politike. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, dhe jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e tjera ligjore (*shih vendimin nr. 78, datë 22.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjlojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia para ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta. Megjithatë, parimi i barazisë nuk e ndalon trajtimin e diferencuar, por trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë mund të përligjet vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e

objektive (*shih vendimet nr. 10, datë 29.2.2016; nr. 71, datë 27.11.2015; nr. 4, datë 12.2.2010; nr. 19, datë 9.7.2009; nr. 39, datë 16.10.2007, të Gjykatës Kushtetuese*).

35. Gjykata ka përcaktuar disa standarde për të vlerësuar nëse një ligj është diskriminues, bazuar në kushtet dhe kriteret që parashikohen në nenin 18 të Kushtetutës. Në të tilla raste ajo shqyrton nëse ligji parashikon trajtim të diferencuar të subjekteve dhe, në rast se e konstaton këtë fakt, vlerëson nëse diferencimi ka qenë i përligjur dhe për arsye objektive. Kjo përligje vlerësohet e lidhur me qëllimet dhe efektet e masave të marra. Gjithashtu, nuk mjafton vetëm diferencimi i përligjur, por edhe që mjeti i përzgjedhur për arritjen e qëllimit të ligjvënës të jetë i arsyeshëm dhe i përshtatshëm (*shih vendimin nr. 48, datë 15.11.2013, të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Gjithashtu, Gjykata, në jurisprudencën e saj, ka theksuar se përkufizimi i një rregullimi juridik pavarësisht nëse është ose jo *objektivisht* i arsyetuar, kërkon edhe një vlerësim real. Diferencimet, si dhe arsyet që çojnë tek to ose kundër tyre, duhen ballafaquar për t'ia lënë në dorë përfundimisht vendimin organit kompetent, sipas kriterëve të tij. Mënyra e zgjidhjes është një e drejtë e organit përkatës, sepse çdo çështje ka specifikat e saj. Sipas praktikës së Gjykatës, jemi para diskriminimit, kur subjekte juridike që ndodhen në të njëjtën gjendje trajtohen në mënyra të ndryshme pa justifikim ligjor të arsyeshëm dhe objektiv. Natyrisht që përkufizimi i çdo kriteri për ta cilësuar arsyetimin *objektiv* varet në një masë të madhe nga çmuarja e vlerave dhe nuk mund të jetë i përcaktuar në mënyrë precize (*shih vendimet nr. 48, datë 15.11.2013; nr. 4, datë 12.2.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

37. Në lidhje me parimin e konkurrencimit të lirë të partive politike shteti ka detyrimin të respektojë shanset e barabarta të të gjitha partive dhe legjislacionin që rregullon kushtet e këtij konkurrimit, si dhe mosmarrëveshjet midis pjesëmarrësve në të. Duke qenë se parimi i konkurrencimit të lirë ndikon në respektimin e parimit të barazisë para ligjit, çdo ndërhyrje nga ligjvënësi mbi këto kushte duhet të udhëhiqet nga interesi publik. Ligjvënësi e ka të ndaluar të trajtojë palët në mënyrë të dallueshme nga njëra-tjetra, përveçse kur ekzistojnë arsye të forta përjashtimore për ta bërë këtë (*shih vendimin nr. 32, datë 21.6.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

38. Nga ana tjetër, Gjykata ka theksuar se është e drejtë e ligjvënësit të përcaktojë me ligj masën e buxhetit të shtetit që do të jepet për financimin e partive politike. Ligjvënësi e ka lidhur shpërndarjen e këtyre fondeve me rezultatin e zgjedhjeve dhe numrin e mandateve përfaqësuese në Kuvend, sepse kjo reflekton pozicionin real të një partie politike dhe veçanërisht shkallën e pjesëmarrjes në pushtetin legjislativ. Ky është një kriter i mjaftueshëm për t'i ndarë partitë politike në ato që kanë një domethënie reale për veprimtarinë politike në vend, bazuar në vullnetin e votuesve që ato përfaqësojnë, dhe në ato që nuk arrijnë të përfaqësojnë një pjesë domethënëse të zgjedhësve, pasi rezultojnë të pasuksesshme në zgjedhje. Ky parashikim ka si qëllim të kufizojë ekzistencën e subjekteve që marrin pjesë në zgjedhje, kryesisht për të përfutur fonde nga buxheti i shtetit, por që nuk kanë peshë reale në jetën politike të vendit dhe mbështetje domethënëse nga zgjedhësit. Partitë politike kryejnë funksionin e përfaqësimit të interesave të ndryshme dhe synojnë realizimin/përmbushjen e tyre me mjete demokratike, pra përfaqësimit në asamblatë përfaqësuese. Ato parti që nuk marrin pjesë në zgjedhje, ose nuk marrin mjaftueshëm mbështetje publike, qartësisht nuk japin të njëjtin kontribut në përcaktimin e vullnetit politik të popullit (*shih vendimin nr. 28, datë 9.5.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

39. Financimi i partive politike është shqyrtuar edhe nga gjykatat kushtetuese të vendeve të tjera. Kështu, ajo e Republikës Çeke ka ndaluar në të drejtat e partive politike për të përfutur financim për fushatën zgjedhore, duke përcaktuar pragun dhe vlerën monetare për çdo votë, por nuk bën dallim për partitë politike që garojnë në koalicion. Ajo ka vlerësuar se kufizimi i shtetit i vendosur për financimin nga buxheti i shtetit nuk ishte antikushtetues, për sa kohë ai nuk shkon mbi pragun e arsyeshëm që nxit pjesëmarrjen e partive politike në zgjedhje (*shih vendimin nr. IV/82S 828/17, të Gjykatës Kushtetuese të Çekisë*). Gjithashtu, ajo ka gjykuar për qëllimin e financimit, duke arritur në përfundimin se është me rëndësi që ky financim të garantojë seriozitetin e

zgjedhjeve, jo të pengojë konkurrencën e lirë të partive politike, duke vendosur një prag të arsyeshëm nën 2% (shih vendimin nr. Pl. ÚS 30/980, të Gjykatës Kushtetuese të Çekisë).

40. Çështja e financimit të partive politike është trajtuar edhe nga Gjykata Kushtetuese e Lituanisë, e cila ka shqyrtuar ligjin lituanëz “Për partitë politike”, për financimin e tyre dhe e ka konsideruar atë kushtetues, pasi financimi do të bëhej në përputhje me formulën përkatëse të votave të fituara prej partive politike. Sipas saj, financimi i veprimtarive të partive politike gjatë vitit zgjedhor bëhet në bazë të rezultateve të zgjedhjeve të mëparshme, ndërsa për zgjedhjet e reja, sipas peshës politike të partive në parlament (shih vendimin e datës 7 qershor 2019, të Gjykatës Kushtetuese të Lituanisë). Po kjo gjykatë, në një rast tjetër ka vlerësuar se ligjvënësi është i lirë të vendosë për mënyrën e financimit të partive politike, kandidatët e të cilave kanë fituar bindshëm në zgjedhjet përkatëse por, nga ana tjetër, ka vlerësuar se ai **nuk** duhet të vendosë kushte që ushtrojnë ndikim negativ në zhvillimin e lirë të sistemit pluralist ose rëndojnë në mënyrë shpërpjesëtimore mbi partitë politike që nuk përmbushin kushtet për marrjen e fondeve nga buxheti i shtetit (vendim i datës 29 mars 2012 i Gjykatës Kushtetuese të Lituanisë).

41. Edhe Gjykata Kushtetuese e Gjermanisë e ka trajtuar disa herë çështjen e financimit të partive politike. Një vendim i saj, i vitit 1992, solli ndryshime në financimin e partive politike nga buxheti i shtetit, bazuar në një skemë të re - financimin e pjesshëm, bazuar në votat e fituara (1 markë gjermane për votë për zgjedhjet në organet e Bashkimit Evropian, Bundestag dhe lande dhe gjysmë marke gjermane për kuotat dhe kontributet e donatorëve). Gjithashtu, me vendimin e saj u përcaktua buxheti total për të gjitha partitë në kufirin maksimal deri në 230 milionë marka. Të drejtën e këtij financimi publik e gëzojnë partitë politike që arrijnë prapun 0.5% (për Bundestagun dhe Parlamentin Evropian) ose 1% të votave (për landet) (shih vendimin 2BvE 8/89, 9 prill 1992, të Gjykatës Kushtetuese të Gjermanisë).

42. Nisur nga sa më lart, Gjykata vlerëson se financimi i partive politike, si dhe masa e tij kanë nevojë të mbështeten në kriteret e qarta e të arsyeshme, ndër të cilat parësore është shkalla e suksesit të një partie politike në zgjedhjet pararendëse. Një subjekt zgjedhor, që ka marrë vota të konsiderueshme në zgjedhje, i takon të përfitojë më tepër fonde sesa një tjetër që nuk ka marrë po aq vota. Financimi i fushatës zgjedhore nga buxheti i shtetit, si një ndër burimet e financimit të subjekteve zgjedhore, merr rëndësi të dyfishtë edhe për një arsye tjetër, atë të shmangies së ndikimit që mund të ushtrojnë mbi to në të ardhmen subjekte të ndryshme private, të cilat mund t’ua financojnë fushatën. Financimi i partive politike nga buxheti i shtetit duhet të jetë një ndër zërat më të rëndësishëm jo vetëm gjatë zhvillimit të fushatës zgjedhore, por edhe gjatë periudhës mes zgjedhjeve, gjatë veprimtarisë së zakonshme të tyre, për shkak të statusit kushtetues të veçantë që ato kanë si pjesëtarë të domosdoshme në jetën politike e shoqërore të vendit.

43. Duke iu rikthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se, nga parashikimet e nenit 64, paragrafit të 1-rë, të Kushtetutës, të cilat kufizojnë shpërndarjen e mandateve vetëm për subjektet zgjedhore që arrijnë prapun kombëtar, ligjvënësi ka ndërhyrë në Kodin Zgjedhor duke i shtuar nenit 65, paragrafin e 3-të. Ky paragraf kërkon që në momentin e regjistrimit, koalicioni, si subjekt zgjedhor, të deklarojë partinë politike që e përfaqëson dhe e udhëheq në fushatën zgjedhore. Kjo do të thotë se për efekt të zbatimit të këtij kodi, të gjitha të drejtat dhe detyrimet që përcakton për subjektet zgjedhore merren përsipër dhe ushtrohen nga partia udhëheqëse e koalicionit. Marrëdhëniet midis partive pjesëtarë, përfshirë të drejtat e detyrimet e tyre reciproke, rregullohen në marrëveshjen e koalicionit, e cila është pjesë e dokumentacionit që depozitohet prej tij në KQZ.

44. Ndryshimet e miratuara në Kodin Zgjedhor ndryshuan edhe statusin juridik të subjekteve zgjedhore, për sa u përket koalicioneve të partive që marrin pjesë në procesin zgjedhor. Në këtë

rast partitë politike merren vesh që të caktojnë njëren parti të koalicionit për ta udhëhequr e përfaqësuar atë, të pranojnë siglën përfaqësuese së partisë udhëheqëse, si dhe të caktojnë një numër kandidatësh sipas marrëveshjes përkatëse të koalicionit. Për një parti që është në koalicion, në ndryshim nga një parti që merr pjesë në zgjedhje më vete, koncepti i tërësisë së votave të vlefshme të fituara ka dallim. Ndërkohë që për një parti që merr pjesë më vete është e lehtë të përcaktohet numri i votave të vlefshme të saj, të cilat përkthehen në mandate, për një parti që merr pjesë në zgjedhjet parlamentare në koalicion me parti të tjera, votat e vlefshme të fituara prej saj mund të mos prodhojnë mandat parlamentar.

45. Megjithatë, partitë hyjnë në koalicion për të realizuar disa synime, ndër të cilat, më kryesori lidhet me maksimalizimin e numrit të votave, që më pas përkthehen në mandate sipas rregullave të Kodit Zgjedhor. Për partitë politike të vogla, pjesëmarrja në koalicion sjell avantazhe arritjen e pragut kombëtar prej 1% të votave të vlefshme, si dhe vendosjen e disa kandidatëve të tyre në pjesën fituese të listës, sipas marrëveshjes. Këto avantazhe lidhen më pas drejtpërdrejt me përfitimin e financimit nga buxheti i shtetit, i cili vendos kushtin e arritjes së pragut kombëtar, duke ndjekur më pas rregullat e numrit të mandateve të fituara në raport me numrin e votave të vlefshme. Nga ana tjetër, në rastin e koalicionit nuk mundësohet identifikimi i numrit të përgjithshëm të votave që merr vetë partia politike në koalicion, pasi të gjitha partitë në koalicion garojnë nën siglën e partisë që drejton, por mund të përllogaritet vetëm numri i përgjithshëm i votave të vlefshme që marrin direkt kandidatët e asaj partie politike.

46. Bazuar në parashtrimet e KQZ-së, Gjykata konstaton se ndryshimi që parashikon fjalía e shtuar në nenin 88, paragrafin e 3-të, të ligjit nr. 118/2020, bazuar në nenin 180 të Kodit Zgjedhor, nuk u zbatua në zgjedhjet e përgjithshme të datës 25 prill 2021 dhe shpërndarja e vlerës financiare për partitë politike, përfshirë kërkueset, do të bëhet për zgjedhjet e përgjithshme pasrendëse.

47. Për financimin e partive nga buxheti i shtetit, subjekti i interesuar, KQZ-ja, ka pohuar se rregullimi nga ligjvënësi është i arsyeshëm, pasi në këtë mënyrë shmanget edhe rreziku që vjen nga natyra e paqëndrueshme e marrëveshjeve të koalicioneve të partive politike, gjë që do të sillte pasoja edhe në qëndrueshmërinë e Kuvendit.

48. Në analizë të sa më lart, Gjykata vlerëson se Kodi Zgjedhor vendos kritere të njëjta për të gjitha subjektet zgjedhore, ndër të cilat edhe pragun kombëtar 1%, arritja e të cilit shërben si kusht për të përfituar fonde nga buxheti i shtetit. Në kod trajtohet hollësisht edhe metodologjia për përllogaritjen e fondit nga buxheti i shtetit për financimin e fushatës zgjedhore. Metodologjia që do të zbatohet varet nga forma juridike që zgjedh subjekti për të marrë pjesë në zgjedhje, pra, më vete ose në përbërje të një koalicioni. Për sa i përket mënyrës së përllogaritjes së fondeve nga buxheti i shtetit për koalicionet, subjekti i interesuar, KQZ-ja, paraqiti një shembull ilustrues për zbatimin në praktikë të nenit 88 të Kodit Zgjedhor, duke e konkretizuar me koalicionin me të cilin mori pjesë edhe kërkuesja, Partia Republikane, në zgjedhjet parlamentare të 25 prillit 2021. Nga rezultati paraprak i KQZ-së, koalicioni, në të cilin mori pjesë edhe kërkuesja, mori 622,220 vota, të cilat prodhuan 59 mandate. Fillimisht përcaktohet mesatarja e votave për mandat që del nga pjesëtimi i votave të koalicionit në rang kombëtar me numrin e mandateve. Në funksion të zbatimit të nenit 88, paragrafit të 3-të, të Kodit Zgjedhor, përllogaritja do të bëhet duke mbledhur mesataren e votave për mandat për çdo kandidat të zgjedhur nga radhët e koalicionit. Për kërkuesen mesatarja e votave do të jetë 3 mandate shumëzuar mesataren e votave për koalicionin pra 10,546 vota. Numri i këtyre votave shumëzohet me vlerën monetare të një vote, e cila del nga pjesëtimi i buxhetit të përgjithshëm që përcakton KQZ-ja, sipas Kodit Zgjedhor, me numrin e përgjithshëm të votave të vlefshme.

49. Nga ana tjetër, referuar sërish rezultateve paraprake të zgjedhjeve të shpallura nga KQZ-ja, rezulton se kandidatët e secilës prej partive kërkuese që kanë përfituar mandate në zgjedhjet e përgjithshme të datës 25 prill 2021, kanë marrë një numër më të ulët votash sesa shumatorja e

votave që kanë prodhuar mandatet përkatëse të përfituara, në këndvështrimin e përcaktimeve të nenit 67, paragrafit të 4-t (fjalja e fundit) dhe nenit 88, paragrafit të 3-të (fjalja e fundit) të ligjit nr. 118/2020, rrjedhimisht bazuar në shembullin konkret fondet që u shpërndahen atyre si pjesë përbërëse e koalicionit, janë më të mëdha krahasuar me fondet që do të përfitonin nëse do të konkurronin si parti më vete.

50. Në këto kushte, metodologjia e përdorur për shpërndarjen e fondeve partive anëtare të koalicionit, sipas mandateve dhe jo sipas votave, nuk e cenon parimin e barazisë, pasi ekziston përligjje e arsyeshme dhe objektive, që është pamundësia e identifikimit të votave që merr secila parti si pjesëtare e koalicionit.

51. Në përfundim, pretendimi i kërkueseve se fjalja: *“Për partitë pjesëtare në koalicion, numri i votave të vlefshme takuese përlogaritet duke mbledhur mesataren e votave për mandat për çdo kandidat të zgjedhur nga radhët e tyre”*, e parashikuar në pikën 3, të nenit 88 të Kodit Zgjedhor, bie në kundërshtim me parimin e barazisë para ligjit dhe të konkurrimit të lirë në zgjedhje është i pabazuar.

52. Gjykata çmon se në kushtet që ajo nuk vëren të jenë cenuar parimet e barazisë para ligjit, si dhe të barazisë së votës dhe konkurrimit në zgjedhje, është e panevojshme analiza e pretendimit për cenimin e nenit 83, paragrafit të 3-të, i Kushtetutës. Siç parashtrohet në paragrafin e 18-të të këtij vendimi, bazuar në nenin 134, paragrafin e 2-të, të Kushtetutës, ky pretendim do të vlerësohej së bashku me pretendimet e tjera të kërkueseve, nëse ato do të provonin interesin e tyre. Nga ana tjetër, në procesin e vlerësimit të parashtrimeve të Kuvendit, Gjykata konstatoi se sipas procesverbalit përkatës nisma ligjvënëse e Kuvendit ka qenë e programuar dhe e përfshirë në kalendarin e tij. Gjithashtu, projektligji që propozonte ndryshime e shtesa në Kodin Zgjedhor është paraqitur për shqyrtim më 17 janar 2020, ndryshe nga sa kanë pretenduar kërkuëset.

53. Në përfundim, Gjykata çmon se kërkesa e paraqitur nga kërkuëset është e pabazuar, sipas arsyetimit të këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “a” dhe 134, pika 1, shkronja “gj”, të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 29.6.2021.

Shpallur më 19.7.2021.

Anëtarë: Vitore Tusha (kryetare), Marsida Xhaferllari, Elsa Toska, Altin Binaj, Fiona Papajorgji, Përparim Kalo, Sonila Bejtja